



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Fier, më . .2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të autoveturave të Bashkisë Fier”, (Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik fitues, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 muaj)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50110000-9 – Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe pajisjeve të lidhura;

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 493 768 (dy milion e katerqind e nentedhete e tre mije e shtateqind e gjashtedhete e tete) **lekë pa TVSH.**

Objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi të së cilëve është 2 165 933** (dy milion e njeqind e gjashtedhete e pese mije e nenteqind e tridhete e tre) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier (njesia e prokurimit) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës,

si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas përcaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2022, 2023**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak **se 900 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuara se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: **Pika 1.** *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* **Pika 2/c:** *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e Thjeshtuar, përkatësisht; **Pika 2/c:** *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet*

financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme percaktimin e dy viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te parashikuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Në këte rast, vlera e kërkuar është jo më pak se **450 000 lekë pa TVSH** (*e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet*), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

a- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, te plotësuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik"i ndryshuar, nenit 41, pika 3 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me pak se **450 000 leke pa TVSH** (*e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet*) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, dhe piken 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitetet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 Staf i kryesor dhe mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar inxhinierë dhe specialiste të kualifikuar për realizimin me cilësi të shërbimeve të kërkuara, si më poshtë:

1. Inxhinier mekanik	1 (nje)
2. Xhenerik	1 (nje)
3. Motorrist	1 (nje)
4. Elektroauto	1 (nje)
5. Gomist	1 (nje)

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin një listë të punonjësve me profesionet përkatëse që ushtrojnë, përfshirë të gjitha profesionet e kërkuara nga AK më sipër.

a)-Për inxhinierin mekanik duhet të paraqesin bashkëlidhur:

- Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme),
- *Diplome universitare,*

b)-Për specialistet duhet të paraqesin bashkëlidhur:

- Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme),
- *Dokument që të vertetojë kualifikimin sipas profilit të kërkuar (diplome ose certificate profesionale ose dëshmi kualifikimi, etj.)*

Shënim: Për pikat **a)** dhe **b)** më sipër, operatorët ekonomikë ofertuesë është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a)** dhe **b)**

të pikes 2.3.2, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Ne baze të pikes 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me ane të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me *zerat, natyrën, volumet e preventivit si dhe me numrin e automjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.*

2.3.3 Operatori/ët Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se **5 (pesë) punonjës** për **muajin Qershor 2024**. Në këtë numër përfshihet dhe stafi drejtues.

Shënim: Për pikën 2.3.3 më sipër, operatorët ekonomikë ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën 2.3.3, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Qershor 2024**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Qershor 2024**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri është bërë me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqi punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit Autoriteti Kontraktor (njësia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit **Qershor 2024** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të

sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklarimit dhe te pagesës*), operatoret ekonomike kane afat te shlyejne detyrimet per sigurimet shoqerore e shendetesore brenda dates 20 te muajit pasardhes.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur sipas shërbimit konkret që kërkohet dhe punonjësve specialist që nevojiten dhe qe jane kërkuar për këte shërbim.

Gjykohet se **5 punonjës** janë të mjaftueshëm për realizimin me sukses të shërbimit, objekt kontrate.

2.3.4 Ofertuesi duhet te paraqese dëshmi per disponueshmerine e mjeteve dhe pajisjeve teknike te nevojshme/ambjente, per permbushjen e sherbimeve te kerkuara ne perputhje me specifikimet teknike apo termat e references te dhena ne DST, si me poshte:

- a. Ura ngritese mjetesh, e përshtatshme edhe për fuoristrada min. 2 (dy) cope,
- b. Pajisje (*kompjuter*) për kontrollin dhe testimin (*diagnostikimin*) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit min. 1 (nje)
- c. Pajisje e testimit për kontrollin fizik në sistemin e drejtimit dhe amortizimit për autovetura, fuoristrada (*konvergjences se mjeteve*) min. 1 (nje)
- d. Repart motorrik per kontrollin e motorrave me bango-prove, pajisje kontroll injektoresh, sistemi ftohes dhe testate min. 1 (nje)
- e. Repart xhenerik te kompletuar min. 1 (nje)
- f. Repart elektroaut te kompletuar min. 1 (nje)
- g. Karroatrec per transportin e mjeteve deri ne servis pa pagesë min. 1 (nje) (*pronesi ose qera*)

Shënim: Për pikën **2.3.4 a), b), c), d), e), f), g)** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.4 a), b), c), d), e), f), g)**, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese dokumenta zyrtare qe vertetojne se keto pajisje i ka ne pronesi aktualisht (*dokumenta qe vertetojne blerjen, faturat e blerjes*) **ose** te pasqyruara ne bilancin e shoqerise me zera te vecante **ose** i ka marre me kontrate qeraje te vlefshme. Ne rastin kur jane marre me qira duhet te paraqitet kontrata e qiramarrjes e vlefshme deri ne perfundimin e marreveshjes kuader.

Per piken 2.3.4 g) OE duhet te paraqese lejen e qarkullimit, kolaudimin, siguracionin, dhe kontraten e qerases nese eshte me qera.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, kerkesat për disponimin ose mundësinë e sigurt te disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike të kerkuara në këto kërkesa për kualifikim, bazohet edhe në nevojën për mundësinë e sigurt të disponimit të mjeteve që AK kërkon nga OE, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitet teknik si për mjetet që do të angazhohen në zbatimin e kontratës, ashtu edhe për kapacitet teknike që lidhen me gadishmerinë për plotësimin e tyre në rrethana të caktuara, duke pasur si synim zbatimin e në kohe dhe në çilesi të kontratës objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qira një objekt (*servis*) për realizimin e kontratës, të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit për realizimin e kontratës, dhe të ketë territor të mjaftueshëm për parkimin e mjeteve për kohën që është e nevojshme. Në rastin e ndodhjes së servisit jashtë territorit të Bashkisë Fier, operatori ekonomik do të marrë përsipër të kryejë me shpenzimet e veta transportin vajtje – ardhje të automjeteve që kanë nevojë për shërbime.

Shënim: Për pikën **2.3.5** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5** duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Për këto operator duhet të paraqesë: foto të objektit (*servisit*) ku të pasqyrohen ambjentet e brendshme, repartet, ambjentet e jashtme, etj., si dhe dokumentin e pronësive për servisin (*shoqeruar me hartën treguese hipotekore*) ose kontratën noteriale të qirase me afat deri në përfundim të marrëveshjes kuader për objektin që prokurohet

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që përpara vlerësimit të ofertave, të verifikojë në vend repartet, mjetet, pajisjet teknike dhe të gjitha ambjentet e servisit të sipercituara, me qëllim verifikimin e plotësimin të kushteve të kerkuara.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1/c dhe pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”e ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur

kontratën...”.Vendosja e këtij kriteri është bere duke u bazuar edhe ne ligjin nr.9573 date 03.07.2006 “Per autoriparimin, shitblerjen, depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, te rimorkiove dhe pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit ose te braktisura per veprimtarite qe lidhen me to dhe ne Udhezimin nr.1546 date 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjentin, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet te dërgohen ne ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklaratë se te gjitha pjesët e këmbimit objekt prokurimi, që do të përdoren për mirembajtjen dhe riparimin e automjeteve, do të jenë origjinale, të reja dhe prodhim sipas standarteve të CE ose ekuivalente me te , dhe se operatori ekonomik merr persiper garancinë e pjesëve të këmbimit per jo më pak se 1 (nje) vit, nga data e montimit ose vendosjes, ne perputhje me normativat standarde të mirëmbajtjes së automjeteve, bazuar në km të përshkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion Pjesët e këmbimit të certifikuara sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Me anë të kësaj deklarate synohet që pjesët e këmbimit që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me minimumi 1 vit garanci.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklaratë me ane te se ciles garanton se pjeset e kembimit qe do te perdoren per mjetet objekt prokurimi, do te merren nga kompani prodhuese/distributore te licencuara sipas standartit **ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente te saj.**

Shënim: Për piken e mesiperme operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën e mesiperme.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK dhe Certifikatën e menaxhimit te cilesise **ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente te saj.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, nenit 44, pika 1 dhe 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku është e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera*

vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor; dhe në pikën 6 të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku është e cituar: 6.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit nr. 3341/1 prot. date 20.03.2018, Rekomandimit nr.7998 prot, date 24.12.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune shërbime” ; dhe Rekomandimit nr. 6732 prot. Date 21.10.2020 si edhe rekomandimeve të Sektorit të Koordinimit për procedura të meparshme të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor; si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që autoriteti kontraktor të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të përmbushur me sukses kontratën.

Paraqitja e certifikates **ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente të saj (për OE i kualifikuar i pari)** vlerësohet i rëndësishëm dhe i nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratës pasi bëhet e mundur identifikimi i origjinës së mallrave objekt prokurimi, dhe garanton për cilësinë e pjesëve të kembimit që do të perdoren për mjetet objekt prokurimi.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një Përgjegjës (Drejtnes) Teknik të shoqërisë, i cili duhet të jetë i pajisur me:

Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) të veprimtarisë së auto riparimit (*referuar Ligjit Nr.9573, datë 03/07/2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”* të ndryshuar, (Kategoria VII.3.B.1).

Shënim: Për pikën **2.3.8** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.8**, me sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 1/c dhe pikës 4 të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4/a dhe b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i

ndryshuar. Me ane te ketij kriteri kerkohe te operatoret ekonomike te deshmojne se disponojne licensat profesionale qe parashikohen nga legjislacioni ne fuqi per kryerjen e sherbimeve ,objekt I kontrates te leshuara nga autoritetet kompetente; si dhe operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter bazohet gjithashtu ne Ligjin Nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen , depozitim e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtaritë që lidhen me to”.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Licence, lëshuar nga QKB**, referuar Kodit **VII.3.B.1**, për ushtrimin e veprimtarisë servis automjetesh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe në zbatim të **Udhëzimit të Ministrit të i Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016**, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, si dhe ne ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licensat profesionale për kryerjen e sherbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te ndryshuar

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga Grupi i Punes i ngritur me Urdher te Titullarit AK te Autorizuar me Nr.2695 Prot. date 18.03.2024 “Mbi ngritjen e grupit te Punes per identifikimin e nevojës, hartimin e termave te references se sherbimit dhe

specifikimeve teknike, testimin e tregut dhe perlllogaritjen e fondit limit, si dhe hartimin e kerkesave te vecanta per kualifikim qe lidhen me kapacitetin teknik per zhvillimin e procedures se prokurimit publik me objekt: “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të autoveturave të Bashkisë Fier”, i cili ka përgatitur specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e vecanta te kualifikimit qe lidhen me kapacitetin teknik jane hartuar nga specialistet e fushes pjese e njesise se prokurimit, ne baze te materialit (bashkengjitur) te ardhur me me nr 2695/1prot. dt. 31/05/2024

Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes pjese e njesise se prokurimit.

Specifikimet teknike gjenden bashkengjitur DST ne SPE.

Njësia e prokurimit:
